



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË
BORDI

VENDIM

Nr. 174, Datë 29.08.2024

MBI

**LICENCIMIN E SHOQËRISË “FAETHON” SH.P.K. NË VEPRIMTARINË E
PRODHIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE**

Në mbështetje të neneve 16, 37, pika 2, gërma “a”, 38, pika 1, gërma “a” dhe 39, pika 4, të ligjit nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar; neneve 4, pika 1, gërma “a”, 5, pika 1, gërma “a”, 13 dhe 14, pika 9 të Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike, të miratuar me vendimin e bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 109, datë 29.06.2016, e ndryshuar; si dhe nenit 15 të Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s, miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.06.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 29.08.2024, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 1125/17 prot., datë 27.08.2024, të Drejtorisë së Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes “Mbi kërkesën e shoqërisë “FAETHON” sh.p.k. për licencim në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike”,

Konstatoi se:

- Shoqëria “FAETHON” sh.p.k., me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 1125 prot., datë 21.05.2024, ka paraqitur kërkesën për licencim në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga centrali fotovoltaik, me kapacitet prodhues 93 MW, me vendndodhje në Zonën Kadastrale Nr. 2444, Bashkia Libohovë, Qarku Gjirokastrë.
- Bordi i ERE-s me vendimin nr. 104, datë 31.05.2024, vendosi të fillojë procedurën për licencimin e shoqërisë në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike.
- ERE botoi njoftimin në median e shkruar për fillimin e kësaj procedure (në datat 04.06.2024 dhe 05.06.2024) dhe në përfundim të afatit të pritjes së komenteve apo objeksioneve nga të tretët (data 03.07.2024), nuk rezultoi të ketë të tilla. Njoftimi për fillimin e procedurës u botua edhe në faqen zyrtare të internetit ERE-s.
- ERE me shkresën nr. 1481 prot., datë 06.06.2024, ka njoftuar Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë (MIE) për fillimin e kësaj procedure. Ndërsa me shkresën nr. 1125/3 prot., datë 04.06.2024, ERE i është drejtuar shoqërisë duke i njoftuar vendimin e fillimit të procedurës

dhe i ka kërkuar plotësimin e informacionit/dokumentacionit të konstatuar të munguar apo të plotësuar pjesërisht.

- Pas shqyrtimit të sa depozituar nga shoqëria, ka rezultuar se ka ende dokumentacion të paplotësuar, ndaj me vendimin nr. 155, datë 31.07.2024, bordi i ERE-s vendosi të zgjasë deri në 30 (tridhjetë) ditë vendimmarrjen e tij mbi aplikimin e shoqërisë “FAETHON” sh.p.k. për licencim në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike.
- Pas seancës dëgjimore të mbajtur në ambientet e ERE-s, në datën 15.08.2024 dhe korrespondencës së zhvilluar në vijim me shoqërinë, rezulton se ajo ka plotësuar tërësisht dokumentacionin në zbatim të përcaktimeve të nenit 9 të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, e ndryshuar, konkretisht, për pikën 1.1, gërmat “a”, “b” dhe “c”; për pikën 1.2, gërmat “a”, “b”, “c” dhe “d”; për pikën 1.3 gërmat “a”, “b” dhe “c”; për pikën 2.1 gërmat “a”, “b”, “c”, “d”, “e” dhe “f”, si dhe ka kryer pagesën e aplikimit sipas përcaktimeve të Aneksit A të kësaj rregulloreje.
- Rezulton se shoqëria “FAETHON” sh.p.k.:
 - Ka nënshkruar me MIE-n, Kontratën nr. 2427 rep., nr. 1333 kol., datë 05.04.2024 “Për ndërtimin, shfrytëzimin dhe administrimin e centralit gjenerues të energjisë elektrike fotovoltaike, me kapacitet prodhues 93 MW, i cili nuk është objekt koncesioni, dhe veprave ndihmëse, në zonën kadastrale nr. 2444, Bashkia Libohovë, Qarku Gjirokastrë, nga shoqëria “FAETHON” sh.p.k.”;
 - Ka nënshkruar me shoqërinë “Operatori i Sistemit të Transmetimit” (OST) sh.a. Marrëveshjen për lidhjen me rrjetin e transmetimit të parkut fotovoltaike Libohovë, në datën 03.06.2024, për lidhjen e parkut fotovoltaike Libohovë me fuqi të instaluar prej 78.6 MW AC me rrjetin 110 kV të transmetimit;
 - Është pajisur me Deklaratë Mjedisore, lëshuar më datë 04.10.2023, nga Agjencia Kombëtare e Mjedisit (AKM), për të zhvilluar projektin për ndërtimin e parkut fotovoltaike në Libohovë, me fuqi të instaluar 93 MW.
- Aktualisht shoqëria ka një Deklaratë Mjedisore të Vlefshme (deri më 04.10.2025) dhe ka njoftuar se nuk ka filluar ende punimet, pasi është në proces të marrjes së lejes së ndërtimit. Në këto rrethana vlerësohet që t’i lihet kusht asaj që të raportojë në ERE në mënyrë periodike, çdo 3 muaj në lidhje me ecurinë e fillimit të punimeve për ndërtimin e parkut fotovoltaike dhe të dokumentojë fillimin e tyre jo më vonë se data 04.10.2025, që është dhe afati i fundit i vlefshmërisë së Deklaratës Mjedisore, afat i cili është brenda afateve të përcaktuara në kontratën me MIE-n.
- Në nenin 9 të Rregullores, pika 2.1 kërkon që për t’u pajisur me licencë për prodhimin e energjisë elektrike, aplikuesi duhet të depozitojë gjithashtu formatin e plotësuar me të dhënat teknike sipas shtojcës 2 të Rregullores dhe duke iu referuar gërmës “a”, pikës 2, shoqëria ka plotësuar se kapaciteti i instaluar do të jetë 78.6 MW AC, si dhe duke iu referuar marrëveshjes me rrjetin e transmetimit për lidhjen e parkut fotovoltaike Libohovë me fuqi të

instaluar prej 78.6 MW AC me rrjetin 110 kV të transmetimit, të lidhur ndërmjet shoqërisë dhe OST sh.a. vlerësojmë se shoqëria duhet të licencohet për fuqinë e instaluar 78.6 MW AC.

- ERE, në zbatim të nenit 38, pika 1, gërma “a” të ligjit nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike” i ndryshuar, si dhe nenit 5, pika 1, gërma “a” të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike” e ndryshuar, lëshon një licencë për veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike deri në 30 vjet. Në rastet analoge ka rezultuar që një central fotovoltaik e ka jetëgjatësinë 25 ose 30 vjet, në varësi të garancisë së paneleve të përdorura. Duke qenë se shoqëria nuk ka paraqitur një dokument teknik në lidhje me jetëgjatësinë e centralit, vlerësohet që licenca të jepet për një afat 25-vjeçar, afati i cili do të fillojë në përputhje me afatet e përcaktuara në VKM-në nr. 67/2024 dhe në kontratën me MIE-n për vënien në punë të parkut fotovoltaik, pra jo më vonë se data 14.02.2027.

Për gjithë sa më sipër, bordi i ERE-s,

Vendosi:

1. Të licencojë shoqërisë “FAETHON” sh.p.k. në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga centrali fotovoltaik me kapacitet të instaluar 78.6 MW AC, me vendndodhje në Zonën Kadastrale Nr. 2444, Bashkia Libohovë, Qarku Gjirokastrë, për një afat 25-vjeçar.
2. Shoqëria duhet të fillojë ushtrimin e aktivitetit të prodhimit të energjisë elektrike nga centrali fotovoltaik, jo më vonë se data 14.02.2027.
3. Shoqëria “FAETHON” sh.p.k., të raportojë në ERE në mënyrë periodike, çdo 3 muaj, në lidhje me ecurinë e fillimit të punimeve për ndërtimin e parkut fotovoltaik dhe të dokumentojë fillimin e tyre jo më vonë se data 04.10.2025
4. Ky vendim është objekt rishikimi nga ERE.
5. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes, të njoftojë shoqërinë “FAETHON” sh.p.k., shoqërinë “Operatori i Sistemit të Transmetimit” sh.a. dhe Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë për vendimin e bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t’i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Petrit AHMETI